



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0008

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga **XX** duke vendosur sipas ankesës së OE “Beni Dona Plast” SH.P.K., ankesës së OE N.T.P “Hajdini Comerc”, si dhe ankesës së OE “Isuf Musliu” B.I., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) në kazermat Prishtinë, Gjilan, Mitrovicë, Istog, Ferizaj, Pomozotin, Gjakovë, Prizren” për nevoja të FSK-së, ndarë në 3 LOT-e. LOT 1. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) kazerma në Prishtinë. LOT 2. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) në kazermat Istog Gjakovë, Mitrovicë dhe Gjilan. LOT 3. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) kazerma në Ferizaj, Pomozotin dhe Prizren” me numër të prokurimit 217-23-5070-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Mbrojtjes, më 12/02/2024, mori këtë:

Vendim

- 1. Aprovohen**, si të bazuara ankesat e OE “Beni Dona Plast SH.P.K.” me nr. 2024/0008 e datës 04. 01. 2024, ankesa e OE “Isuf Musliu B.I. (Global Parajsa)” me nr. 2024/0018 e datës 05. 01. 2024, si dhe ankesa e OE “N.T.P “Hajdini Comerc” me nr. 2024/0026 e datës 08. 01. 2024.
2. Anulohet aktiviteti i prokurimit “Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) në kazermat Prishtinë, Gjilan, Mitrovicë, Istog, Ferizaj, Pomozotin, Gjakovë, Prizren” për nevoja të FSK-së, ndarë në 3 LOT-e. LOT 1. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) kazerma në Prishtinë. LOT 2. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) në kazermat Istog Gjakovë, Mitrovicë dhe Gjilan. LOT 3. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) kazerma në Ferizaj, Pomozotin dhe Prizren”, me numër të prokurimit 217-23-5070-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Mbrojtjes dhe nëse AK ka edhe më tej interes, të njëjtin ta ritenderojë.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mosrespektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik në Kosovë.
4. Lejohet të bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së,

në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 01.06.2023 Ministria e Mbrojtjes në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) në kazernat Prishtinë, Gjilan, Mitrovicë, Istog, Ferizaj, Pomozotin, Gjakovë, Prizren" për nevoja të FSK-së, ndarë në 3 LOT-e. LOT 1. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) kazerna në Prishtinë. LOT 2. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) në kazernat Istog Gjakovë, Mitrovicë dhe Gjilan. LOT 3. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) kazerna në Ferizaj, Pomozotin dhe Prizren", me numër të prokurimit 217-23-5070-2-1-1.

Njoftimi i AK-së B58 pas rivlerësimit publikohet me datë 20.12.2023 ku janë rekomanduar për kontratë në tri lote, tre operator ekonomik: LOT 1: NTP "Global Parajsa & Delfin SHPK; LOT 2: NNH "Verona & NTP Hajdini Commerce & Bylmeti SHPK; LOT 3: "Beni Dona Plast" SHPK.

Me datën 27.12.2023, kërkesë për rishqyrtim ka parashtruar operatori ekonomik "Global Parajsa" për LOT 1 të cilën AK i ka refuzuar me datën 27.12.2023.

Me datën 27.12.2023, kërkesë për rishqyrtim ka parashtruar operatori ekonomik "Beni Dona Plast" për LOT 1 dhe LOT 2 të cilën AK i ka refuzuar me datën 27.12.2023.

Me datën 04.01.2024, OE "Beni Dona Plast SH.P.K." në OSHP ka parashtruar ankesë me nr 2024/0008, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë për LOT 1 GOE "Global Parajsa & Delfini LTD" dhe për LOT 2 GOE" NNH Verona & Hajdini Commerce NTP& Bylmeti-KS, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) në kazernat Prishtinë, Gjilan, Mitrovicë, Istog, Ferizaj, Pomozotin, Gjakovë, Prizren" për nevoja të FSK-se, për LOT 1. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) kazerna në Prishtinë. LOT 2. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) në kazernat Istog Gjakovë, Mitrovicë dhe Gjilan. me nr. të prokurimit: "217-23-5070-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Mbrojtjes.

Me datën 05.01.2024, OE "Isuf Musliu B.I." (emri tregtar Global Parajsa), ka parashtruar ankesë me nr: 2024/0018, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë për LOT 2: NNH "Verona & NTP Hajdini Commerce & Bylmeti SHPK dhe për LOT 3- GOE "Beni Dona Plast"- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) në kazernat Prishtinë, Gjilan, Mitrovicë, Istog, Ferizaj, Pomozotin, Gjakovë, Prizren" për nevoja të FSK-se, për LOT 2. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) në kazernat Istog Gjakovë, Mitrovicë dhe Gjilan. LOT 3. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) kazerna në Ferizaj, Pomozotin dhe Prizren" me nr. të prokurimit: "217-23-5070-2-1-1.

Me datën 08.01.2024, OE N.T.P "Hajdini Comerc", ka parashtruar ankesë me nr: 2024/0026, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë GOE "Global Parajsa SHPK & Delfini LTD", lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) ne kazermat Prishtine, Gjilan, Mitrovice, Istog, Ferizaj, Pomozotin, Gjakove, Prizren" për nevoja te FSK-se, LOT 1. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) kazerma ne Prishtine me nr. të prokurimit: "217-23-5070-2-1-1".

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore. Poashtu konform nenit 16 par 1 i Rregullores së Punës së OSHP 01/2020 (e amendamentuar) bëhet bashkimi i lëndëve pasi që kemi të bëjmë me të njëjtin aktivitet të prokurimit.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE "Beni Dona Plast SH.P.K." Nr. 0008/2024 janë parashtruar si në vijim:

Pretendimet tona ankimore lidhur me vendimin e AK që ka të beje me shpërblimin me kontrate për LOT 1. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) kazerma në Prishtinë, që me kontrate është shpërblyer Grupi i OE: NTP"GLOBAL PARAJSA"; Delfin L.t.d. SH.P.K në vlerë prej: 3,998,750.00 €. Pretendimi 1: Autoriteti Kontraktues, në Dosjen e Tenderit (FDT) të neni 9.1 & 9.2 - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale dhe në Njoftimin për Kontrate të neni III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional, të kërkesa nr. 13 ka kërkuar: Kërkesa 13. Operatori ekonomik duhet të ofroje dëshmi për produktet e ofruara me te cilat oferton e qe do te jene pjese e përgatitjeve te ushqimit, (sipas menyve te paraqitura ne DT aneksin 1 specifikimet teknike te detyrueshme); Evidenca 13. Lista e artikujve duke përfshi katalogun ose fotografit për produktet e ofruara me përshkrim emrin e prodhuesit vendin e origjinës si dhe përmbajtjen mbi përbërjen e artikulli, për artikujt që kane përshkrim teknik, pemët dhe perimet nuk ka nevoje përshkrimi teknik - i vulosur dhe nënshkruar nga OE ne original. Për ta plotësuar Kërkesën nr. 13, Grupi i OE: NTP"GLOBAL PARAJSA"; Delfin L.t.d. SH.P.K, së bashku më ofertën ka dorëzuar një katalog të përgjithësuar të Kompanisë Delfin L.t.d. SH.P.K, në të cilin janë të pasqyruar disa lloje të artikujve ushqimor që kjo kompani i tregton në tregun e Kosovës por në asnjërin prej tyre nuk është e shënuara përmbajtja e përbërjes së artikujve ashtu siç ka kërkuar AK ne kërkesën nr. 13. Gjithashtu në këtë katalog ka edhe artikuj për të cilët është dërguar vetëm fotografia që janë bere në dyqane të ndryshme pa asnjë përshkrim të përbërjes së artikujve. Ka raste kur vetëm i kane fotografuar vitrinat e dyqanit të mishit dhe të njëjtat fotografi i kane dërguar të AK së bashku me ofertën pa asnjë përshkrim. (Dëshmia 1- Katalogu i përgjithësuar i Kompanisë Delfin L.t.d. SH.P.K). Gjithashtu së bashku me ofertën është dorëzuar edhe një katalog i kompanisë tregtare ANANAS IMPEX në të cilin janë të shënuara disa artikuj të melmesave të ndryshme që kjo kompani tregtare i tregton në tregun e Kosovës, por edhe në këtë katalog në asnjërin prej tyre nuk është shënuar përmbajtja e përbërjes së artikujve ashtu siç ka kërkuar AK në kërkesën nr. 13. (Dëshmia 2- Katalogu i përgjithësuar - kompanisë tregtare ANANAS). Ky Grup i OE ka dërguar edhe Listat e artikujve pa asnjë përmbajtje të përbërjes së

artikujve ashtu siç ka kërkuar AK në kërkesën nr. 13. (Dëshmia 3 - Listat e artikujve që Grupi i OE: NTP"GLOBAL PARAJSA" Delfin L.t.d. SH.P.K, ka dorëzuar së bashku më ofertën). Prandaj, katalogët, fotografitë dhe Listat e artikujve të cilat i ka dërguar Grupi i OE: NTP"GLOBAL PARAJSA"; Delfin L.t.d. SH.P.K, së bashku me ofertën të AK, as për se afërmi nuk e plotësojnë kërkesën nr. 13 të kërkuar nga AK në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontrate, ku saktësisht ka kërkuar - Listën e artikujve duke përfshi katalogun ose fotografitë për produktet e ofruara me përshkrim emrin e prodhuesit vendin e origjinës si dhe përmbajtjen mbi përbërjen e artikulli, për artikujt që kanë përshkrim teknik ndërsa vetëm për pemët dhe perimet nuk ka kërkuar që të behet përshkrimi teknik. Autoriteti Kontraktues - Ministria e Mbrojtjes, në faqen 45 të Dosjes së Tenderit të Aneksi nr. 1- Specifikat Teknike të Detyrueshme - ka vendosur tabelën e Identifikimit të Operatorit Ekonomik (OE), ku ka qene obligim i çdo OE që oferton në këtë aktivitet të prokurimit që ta plotësojë këtë tabelë , ta nënshkruaj, vulosë dhe ta dërgoj të AK së bashku me ofertën.

Grupi i OE: NTP"Global Parajsa"; Delfin L.t.d. SH.P.K, fare nuk e ka plotësuar, nënshkruar, vulosur dhe dërguar të AK - Aneksin nr. 1- Specifikat Teknike të Detyrueshme. (Dëshmi 4- Faqja 45 e Dosjes së Tenderit). Bazuar në nenin 56 paragrafi 1 pika 1.1 të LPP , nenin 59 paragrafi 4 të LPP, nenin 25 paragrafi 1 i Rregullores Nr. 01/2022 për Prokurim Publik dhe nenin 40 paragrafi 40.2 i Rregullores Nr. 01/2022 për Prokurim Publik, Autoriteti Kontraktues - Komisioni i Ri vlerësimit të ofertave është dashur që ofertën e Grupit të OE: NTP"GLOBAL PARAJSA" ; Delfin L.t.d. SH.P.K , automatikisht ta konsideroj si oferte të pa përgjegjshme dhe ta eliminojë nga aktiviteti i prokurimit për faktin së nuk i ka plotësuar të gjitha kriteret - kërkesat e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontrate, konkretisht kërkesën nr, 13 të Kapacitetit Teknik dhe Profesionale dhe kërkesën për plotësimin dhe dërgimin e Aneksit nr.1- Specifikat Teknike të Detyrueshme.

Pretendimi 2: Autoriteti Kontraktues - Ministria e Mbrojtjes në Dosjen e Tenderit në neni 2.5 të FDT - Ndarja në Lote, ka shënuar: Ndarja ne Lote: Po [X]. Objekti i kontratës është i ndare në [3] pjesë (lote). Tenderuesi mund të paraqesë tender [për një apo më shumë pjesët (lote)]. Secila pjesë e lot-it është e shënuar në specifikacionit teknik, shih Aneksin 1, dhe ofertës financiare Pjesa. II. Lista e çmimeve. Ndërsa në nenin 2.6, të FDT - Vlera e parashikuar për tri vite ka shënuar: Pjesa: 3,340,000 6; Pjesa2: 5,280,000.00 6; Pjesa3: 4,380,000.00 6; Autoriteti Kontraktues - Ministria e Mbrojtjes me vendimin që ka marrë për ta shpërblyer me kontrate Grupin e OE: NTP"Global Parajsa"; Delfin L.t.d. SH.P.K për LOT 1. Shërbimet me ushqim (furnizim. përgatitje dhe servim) kazerma në Prishtinë, në vlerë prej 3,998,750.00 6, oferte që e tejkalon substancialisht vlerën e parashikuar nga vete AK për 658,750.00 €, jo vetëm që ka bërë shkelje substanciale të nenit 1 të LPP, nenit 6 paragrafi 1 të LPP, dhe nenit 18 paragrafi 8 të Rregullores nr.01/2022 për Prokurim Publik. por konsiderojmë së ka indikacione të shkaktimit edhe të veprës penale. Sikur AK - Ministria e Mbrojtjes të kishte vepruar konform legjislacionit primar dhe sekondar të prokurimit publik të aplikueshëm në Republikën e Kosovës dhe kërkesave që vete AK i ka përcaktuar në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimit për kontrate, duke përfshi edhe vlerën e parashikuar dhe mundësin që ka pasur që me kontrate të shpërblejë OE edhe për ma shumë së një Lot në rast kur nuk ka oferta të përgjegjshme, që në rastin konkret vetëm oferta e kompanisë tone Beni Dona Plast SH.P.K, është oferte e përgjegjshme, buxheti i Republikës së Kosovës vetëm për Lotin 1- nuk do të keqpërdorej për 862,350.00 €. Ky keqpërdorim i mjeteve buxhetore do të ishte parandaluar sikur Autoriteti Kontraktues të kishte vepruar konform nenit 18.8 të Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik dhe kriterëve që ka caktuar vete në Dosjen e Tenderit në nenin 2.5 të FDT - ku edhe për Lot 1 është dashur që me kontrate të shpërblejë ofertën e vetme të përgjegjshme të kompanisë tone Beni Dona PLast me

çmimin total për Lot 1 prej 3,136,400.00 €. Fatkeqësisht Autoriteti Kontraktues - Ministria e Mbrojtjes, nuk vepron konform legjislacionit primar dhe sekondar të prokurimit publik, por vendosi që me kontrate për Lot 1 ta shpërblej Grupin e OE: NTP"Global Parajsa"; Delfin L.t.d. SH.P.K, oferta e të cilëve jo vetëm që as për se afërmi nuk i plotëson të gjitha kriteret - kërkesat e kërkuar nga AK, por është edhe për 658,750.00 € me e larte krahasuar me vlerën e parashikuar nga vete AK për Lot 1 dhe është për 862,350.00 € me e larte krahasuar me ofertën e kompanisë tone si e vetmja oferte e përgjegjshme në këtë aktivitet të prokurimit. Komisioni i Ri-vlerësimit të ofertave në faqen 25 të Raportit të Ri- Vlerësimit të Tenderëve, ka shënuar: Nga këto të dhëna të shënuara në Raportin e Ri- vlerësimit të ofertave shihet së Grupi i OE: NTP"GLOBAL PARAJSA" ; Delfin L.t.d. SH.P.K, në total për tri lotet e ka tejkaluar vlerën e parashikuar nga AK në total për 2,598,870.00 € dhe krahasuar me ofertën tone për të tri lotet ka dorëzuar oferte për 4,010,520.00 € me te shtrenjte së oferta e kompanie ton Beni Dona PLst SH.P.K. Komisioni i Ri-vlerësimit të ofertave në faqen 26 të Raportit të Ri- Vlerësimit të Tenderëve, ka shënuar: Nga këto të dhëna të shënuara në Raportin e Ri- Vlerësimit të Tenderëve, shihet së komisioni i ri-vlerësimit të ofertave e ka pasur shume të qarte së Grupi i OE: NTP"GLOBAL PARAJSA"; Delfin L.t.d. SH.P.K, e ka tejkaluar substancialisht vlerën e parashikuar nga vete AK, por prape së prape ka vazhduar me shpërblim me kontrate këtë Grup të OE për Lot 1 duke e dëmtuar buxhetin e qytetareve të Republikës së Kosovës , vetëm për Lot 1 për 862,350.00 €. Shtrohet pyetja nga çfarë grupe të interesit u inkurajua ky Grup i OE që të ofertoj me këso çmimesh marramendëse në këtë aktivitet të prokurimit që buxhetin e Republikës së Kosovës të tentoje ta dëmtoj për mbi katër milion euro. Duhet theksuar së përfaqësuesit e kompanisë NTP"GLOBAL PARAJSA" në bashkëpunim edhe me grupe të interesit brenda institucioneve, ka vite që me shantazhe dhe spekulime, tentojnë që më çdo kusht kompaninë tone Beni Dona Plast SH.P.K ta eliminojnë nga tregu duke bere kërkesa për futjen e kompanisë tonë në Listën e zeze, pa kurrfarë argumente, duke dërguar shkresa dhe pretendime të pa vërteta në institucione tjera me të vetmin qëllim dëmtimin e reputacionit të kompanisë sonë. Të gjitha këto shantazhe dhe spekulimi i bëjnë me të vetmin qëllim që të eliminojnë nga tregu konkurrencën dhe të vazhdojnë me zhvatjen e buxhetit të qytetareve të Republikës së Kosovës ashtu siç janë duke tentuar në këtë aktivitet të prokurimit, ku për tri lloje kane ofertuar për 4,010,520.00 € me çmim me të larte së oferta e kompanisë ton Beni Dona Plast SH.P.K. Nëse edhe me tutje vazhdohet me këto shkelje substanciale të legjislacionit të prokurimit publik dhe dëmtim të buxhetit të qytetareve të Republikës së Kosovës për miliona euro, në jemi të detyruar që këtë çështje ta ngrisim në Institucione tjera ligj zbatuese. Autoriteti Kontraktues, në Dosjen e Tenderit (FDT) të neni 9.1 & 9.2 - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale dhe në Njoftimin për Kontrate të neni 111.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional, të kërkesa nr. 10 ka kërkuar: Kërkesa 10. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te natyrës se njëjte apo te ngjashme ne fushën e gastronomisë (përgatitje dhe servime të ushqimit gjate 3 (tri) vitet e fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontratë), me institucion publike dhe private, jo me pak se Pjesa 1 2,000,000.00 € ; minimumi i kësaj vlerë të kërkuar duhet të jetë për shërbime 50% (1,000,000.00 €), dhe pjesa tjetër mund të jetë për furnizime; Pjesa 2 2,000,000.00 €; minimumi i kësaj vlerë të kërkuar duhet të jetë për shërbime 50% (1,000,000.00 €), dhe pjesa tjetër mund të jetë për furnizime; Pjesa 3 € 2,000,000.00 €; minimumi i kësaj vlerë të kërkuar duhet të jetë për shërbime 50% (1,000,000.00 €), dhe pjesa tjetër mund të jetë për furnizime; Shënim Plotësues Në rast se Operatori ekonomik dorëzon tender me shumë se një pjesë, atëherë kërkohet qe te plotësohet shuma më e lartë e që kërkohet për Lotët për të cilat konkurron duhet të përmbushet nga OE është si me poshtë. 1. Nëse OE vendos që të konkurrojë për Pjesën 1 dhe 2, atëherë kërkesa minimale e cila duhet të përmbushet nga OE është 2,000,000.00 Euro 2. Nëse OE vendos qe të konkurroj ne Pjesën 2 dhe 3, atëherë kërkesa minimale e cila duhet të përmbushet

nga OE është 2,000,000.00 Euro 3. Nëse OE vendos që të konkurroj për të 3 Pjesët, atëherë kërkesa minimale e cila duhet të përmbushet nga OE është 2,000,000.00 Euro NJOFTIM Në rast se për tenderin në fjalë aplikoni si grup i OE atëherë lideri i konzerciumit duhet të përmbushë 50% të vlerës së kërkuar për shërbime € (shërbime është kërkuar minimumi 50% ose 1,000,000.00 € , atëherë lideri duhet të mbulojë minimumi 50% të vlerës për shërbime (500,000.00 €) me kontrata të realizuar dhe vlera tjetër mundet të plotësohet nga anëtarët tjetër të grupit përfshirë shërbimet dhe furnizimet. Evidenca 10 Dëshmia e kërkuar dokumentare Listën e kontratave - projekteve të realizuar përfunduar gjatë tri viteve të fundit, në origjinal, të nënshkruar dhe vulosur nga Operatori Ekonomik, të dëshmuara me referenca në kopje të nënshkruar dhe vulosur nga Autoritetet përkatëse , për shërbimet furnizimet e realizuara dhe pranuar, të cilat duhet të tregojnë, numrin e prokurimit ose kontratës, vlerën e kontratës , datën e nënshkrimit të kontratës , natyrën e shërbimeve dhe vendin e realizimit të shërbimeve . a. Kur shërbimet furnizimet është bërë për një autoritet publik në Kosovës ose në një vend tjetër, për dëshmi duhet të dorëzohen certifikata e pranimit ose referenca (në referenca të jete e cekur vlera e shërbimeve) të lëshuara nga autoriteti i tillë. Për ta plotësuar Kërkesën nr. 10, Grupi i OE: NNH”Verona”; N.T.P Hajdini Comerc; Bylmeti- KS” së bashku më ofertën ka dorëzuar një Listë të Kontratave të NNH” Verona” ku në këtë listë janë shënuar të dhënat e gjashtë kontratave, ku vlera totale e tyre është 1,357,809.36 €. Të gjitha këto kontrata janë kontrata furnizimi që NNH ”Verona” ka realizuar në Autoritetin Kontraktues - Trepça SH.A Mitrovicë. Kësaj Listë të kontratave i janë bashkangjitur gjashtë referenca të leshura nga AK Trepça SH.A dhe nga dy faqe të kontratës për secilën kontratë. Nga të dhënat që janë të shënuar në Listën e kontratave, Referenca dhe faqen e parë të kontratës shume qarte shihet së të gjitha këto kontrata titullin e kontratës e kanë : Furnizim me shujta për punëtorët e Stantërgut dhe kur aktiviteti i prokurimit është zhvilluar sipas Procedurës së Hapur, tri shifrat e fundit të numrit të prokurimit kanë qene: 111- që do të thotë: Furnizim - Vlere e Madhe - Procedure e Hapur dhe kur aktiviteti i prokurimit është zhvilluar sipas Procedurës së Negociuar pa Publikim të Njoftimit për Kontrate tri shifrat e fundit të numrit të prokurimit kanë qene: 125 - që do të thotë: Furnizim - Vlere e Mesme - Procedurë e Negociuar pa Publikim të Njoftimit për Kontrate. (Dëshmia 1- Listën e kontratave NNH ”Verona”). Së të gjitha këto kontrata janë furnizime e jo shërbime e dëshmon edhe fakti që NNH” Verona” së bashku me ofertën ka dorëzuar të AK një Deklaratë ku shënon: “Të gjitha referencat e prezantuara nga NNH Verona janë Furnizime, në të vërtete janë shërbime dhe përgatitja e ushqimit për punëtorë e Trepçës në Minierën e Stan Terg-ut- Mitrovicë. Kjo deklaratë me së miri e dëshmon që Grupi i OE: NNH”Verona”; N.T.P HAJDINI COMERC; Bylmeti- KS”, shume mire e kanë ditur së nuk kanë asnjë kontratë të realizuar si shërbime ashtu siç ka kërkuar AK , por tentojnë që me një deklaratë mashtruese ta qesin në lajthitje AK që këto kontrata ti pranoj si kontrata të shërbimeve, e që fatkeqësisht deri në këtë fazë ja kanë arritur qëllimit që të mashtrojnë AK. ”.(Dëshmia 2 - Deklarata e NNH Verona e datës 14.07.2023.

Gjithashtu për ta plotësuar kërkesën nr. 10- ky Grup i OE së bashku më ofertën ka dorëzuar një Listë të Kontratave të N.T.P HAJDINI COMERC ku në këtë listë janë shënuar të dhënat gjashtë kontratave, ku vlera totale e tyre është 5,037,360.43 €. Kësaj Listë ja ka bashkangjitur edhe Referencat e leshura nga Autoritetet Kontraktues ku furnizimet e artikujve ushqimor janë kryer. Të gjitha këto kontrata janë kontrata furnizimi të artikujve të ndryshëm ushqimor që N.T.P HAJDINI COMERC, ka realizuar në Autoritetet Kontraktuese - AQP, Shërbimi Korrektues i Kosovës dhe Komuna e Prishtinës. (Dëshmia 3- Listën e kontratave dhe Referencat e N.T.P HAJDINI COMERC). Përndaj bazuar në këto që cekem me lartë shihet qartë së Grupi i OE: NNH ”Verona”; N.T.P HAJDINI COMERC; Bylmeti- KS” nuk ka të realizuar as edhe një kontratë të vetme të shërbimeve ashtu si e ka kërkuar AK në Dosje të Tenderit dhe Njoftimin për Kontrate. Është kërkuar nga AK vlerën prej 2,000,000.00 € ; minimumi i kësaj vlerë të kërkuar

duhet të jetë për shërbime 50% (1,000,000.00 €), prandaj Autoriteti Kontraktues gjate vlerësimit dhe Ri-vlerësimit të ofertave është dashur që të veproj konforme nenit 59 te LPP dhe nenit 40 të Rregullores 01/2022 për Prokurim Publik dhe ofertën e Grupit të OE: NNH ”Verona”; N.T.P HAJDINI COMERC; Bylmeti- KS”, ta konsideroj si oferte të pa përgjegjshme dhe ta eliminoj nga aktiviteti i prokurimit pasi që as për së afërmi nuk e ka plotësuar Kërkesën nr, 10 të kërkuar nga AK në Dosje të Tenderit dhe Njoftimin për Kontrate. Për informate me të detajuara së pse këto kontrata që tre numrat e fundit i kane 111 apo 125 , nuk mund të merren si valide për ta plotësuar Kërkesën nr. 10 të AK- Kapacitetet Teknike dhe Profesionale, Ankesës i bashkëngjisim Vendimin e Panelit Shqyrtues nr. OSHP- 2023/0503 të datës 11.10.2023 dhe Ekspertizën e Ekspertit Shqyrtues Nr. 2023/0503 të datës 27.07.2023. Pretendimi 2: Autoriteti Kontraktues, në Dosjen e Tenderit (FDT) të neni 9.1 & 9.2 - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale dhe në Njoftimin për Kontrate të neni 111.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional, të kërkesa nr. 11 ka kërkuar: Kërkesa 11. OE duhet të ofroje listën e të punësuarve me specifikimin e kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik dhe, në veçanti, të personit ose personave që drejtpërdrejtë është ose janë përgjegjës për ofrimin e shërbimeve pjese e këtij tenderi minimumi duhet Për LOT.1- Prishtinë (dy objekte), numri minimal 20 punonjës të kuzhinës dhe minimum 4 punonjës staf profesional - kuzhinierë të kualifikuar në fushën e gastronomisë si dhe një (1) teknolog i ushqimit (teknologu duhet të kenë minimum diplomë bachellor). Për LOT.2 Istog, Gjakovë, Mitrovicë dhe Gjilan (katër objekte), numri minimal 35 punonjës të kuzhinës dhe minimum 7 punonjës staf profesional- kuzhinierë të kualifikuar në fushën e gastronomisë si dhe një (1) teknolog të ushqimit (teknologu duhet të kenë minimum diplomë bachellor). Evidenca 11; OE duhet të ofroj dëshmi A) Listën e stafit (një pasqyrë tabelore e personelit) profesional, teknologeve , kuzhinierëve dhe të punëtorëve të kompanisë me të dhënat në vijim Emri , mbiemrin , moshja e punëtorit, profesioni, eksperiencia(vite) dhe pozicioni në kompani, e nënshkruar dhe I vulosur nga OE ne origjinal B). Vendim me shkrim për caktimin e menaxherit te projektit dhe 14 ndihmës menaxherit, duhet te behet për secilën pjese për të cilën oferton(nëse aplikon për 3 pjesët atëherë kërkohet dhe ndihmës menaxherit i ndare për të tri pjesët dhe nuk mundet te jete i njëjti) C. Për stafin e kërkuar punonjësit e stafit professional kuzhinierë të kualifikuar në fushën e gastronomisë si dhe teknologet e ushqimit duhet te ofron dëshmitë • Kopje e Diplomës ose Certifikatës, • CV-ja, • Kopja e kontratave të punës ose para kontrata ne origjinal me emër te projektit ne fjale. Për ta plotësuar Kërkesën II, Grupi i OE: NNH”Verona”; N.T.P HAJDINI COMERC; Bylmeti- KS” se bashku me ofertën ka dorëzuar këto dëshmi: Listën e Teknologeve , Vendimet e caktimit të menaxhereve të kontratës, CV, Diplomat të kopanise “Bylmeti- KS”. Listën e Kuzhinierëve të kompanisë N.T.P Hajdini Comerc. Listën e Punonjëseve kompanisë N.T.P Hajdini Comerc. Listën e Punonjëseve të kompanisë “Bylmeti- KS”. Vendimin e Ndhmës Menaxhereve të Kontratës të nënshkruar nga pronari i kompanisë N.T.P Hajdini Comerc. Pas analizimit të këtyre dokumenteve të shënuara me larte kemi konstatuar: Në Listën e Teknologeve të nënshkruar dhe vulosur nga përfaqësuesi i kompanisë “Bylmeti- KS” janë të shënuar këta dy emra: Argjenta Breznica dhe Marjola Memoçela, Ndërsa Vendimet për caktimin e Menaxherit të Projektit për Lot 1 dhe Lotin 2 i ka nënshkruar dhe vulosur Musaj Leku , pronar i kompanisë N.T.P Hajdini Comerc. (Dëshmi 4- Vendimet e caktimit të Menaxherit të Projektit për Lot 1- znj. Argjenta Breznica dhe Lot 2 - znj. Mariola Memoçela). Konsiderojmë së nënshkrimi i vendimeve të menaxhereve të Projektit për Lot 1 dhe Lot 2 nga pronari i kompanisë N.T.P HAJDINI COMERC është bere në kundërshtim të plote me nenin 26, paragrafi 26.1, pika (c) e Rregullores 01/2022 për Prokurim Publik, pasi që sipas këtij neni është i obliguar që grupi ta autorizoj partnerin udhëheqës që të veproj në emër të grupit e jo të pranojnë në emër të grupit edhe persona tjerë. Sipas këtij neni të rregullores nuk ka mundësi që të emërohen dy liderë dhe të

nënshkruajnë dokumente dy persona në emër të të njëjtit grup. Në rastin konkret, Grupi i OE: NNH"Verona"; N.T.P Hajdini Comerc; Bylmeti- KS" në Deklaratën e Themelimit të Grupit të OE, në preambulën e kësaj deklarate ka shënuar: Në emër të Grupit NNH " VERONA" ME NUI 811309097, (në vazhdim "tenderuesi". Gjithashtu në piken d) të Deklaratës shënon: d) Palët deklarojnë qarte se të gjithë anëtarët e grupit autorizojnë partnerin kryesor NNH " VERONA". Për të vepruar në emër të grupit dhe do të jete Kajtaz Kajtazi personi i autorizuar për të nënshkruar Formularin e Tenderit dhe nënshkrimin e Kontratës. (Dëshmia 5 - Deklarate mbi Themelimit e Grupit e datës 14.07.2023). Në piken d) të Deklaratës OE ceken disa nga dokumentet që do të nënshkruhen nga Hajdini Comerc , por kjo klauzole është në kundërshtim të plote me nenin 26, paragrafi 26.1, pika (c) e Rregullores 01/2022 për Prokurim Publik, pasi që nuk ka mundësi që të emërohen dy liderë dhe të nënshkruajnë dokumente në emër të grupit dy persona në emër të të njëjtit grup të OE. Në Deklaratën e garancionet për artikujt ushqimor shënon: Grupi i Operatoreve Ekonomik: Përkatësisht NTP "Hajdini Commerce ", me NUI: 810248220 si Lider, jep garancion që artikujt ushqimor që do të ofrohen në përgatitjen e Ushqimit janë të standardeve që janë kërkuar në Aneksin Nr.1 shih katalogun e bashkangjitur me specifikimet teknike dhe foto". (Dëshmia 6 - Deklarate për garancionin e artikujve e datës 14.07.2023).

Pretendimi 3: Në Listën e Kuzhinierëve të kompanisë N.T.P HAJDINI COMERC janë të shënuar emrat e 11 Kuzhinierëve, por në tri Diploma - Certifikata nuk shihet fara vula e Institucionit që ka lëshuar Diplomën- Certifikatën dhe në dy prej tyre mund të ketë pasur ndërhyrje në të dhënat e shënuara në këtë Certifikatë. Këto lëshime janë : Nr. 2- Fatmir Nika- Diplome e pa vulosur- (Dëshmia 8- Diploma e Fatmir Nika e datës 03.09.2001); Nr. 3- Drita Çuni - Në certifikate nuk shihet vula dhe mund të ketë pasur ndërhyrje. (Dëshmia 9- Certifikata e Drita Çuni e datës 08.06.2015); Nr. 6- Fatime Redja- Në certifikate nuk shihet vula dhe mund të ketë pasur ndërhyrje. (Dëshmia 10- Certifikata e Fatime Redza e datës 28.10.2013);

Pretendimi 4: Në Listën e Punonjëseve të kompanisë " Bylmeti- KS", janë të shënuara emrat e 55 të punësuarve dhe të rubrika - Pozicioni në kompani, për 53 prej punëtorëve, shënon - Ndihmës në Kuzhinë. Konsiderojmë së këto të dhëna të shënuar në këtë liste nuk janë sakta dhe mund të konsiderohen edhe si mashtruese, për faktin që një kompani që merret ekskluzivisht me prodhimin e qumështit, në asnjë mënyre nuk ka mundësi që ti ketë të punësuar 53 Ndihmës në Kuzhinë. (Dëshmia 11- Lista e të punonjëseve të kompanisë "Bylmeti- KS"). Pretendimi 5: Në vendimin e anëtarit të konzorciumit Hajdini Commerce të datës 14.07.2023 Mbi caktimin e Ndihmës Menaxherit në Projekt pos tjerash shënon: Menaxher të projektit, cakton z. Fatmir Nika - Kuzhinjer. Ky përshkrim në këtë vendim, automatikisht Vendimin e caktimit të Ndihmës Menaxherit të Projektit e bene jo valid për faktin së në një vend të këtij vendimi shënon "Mbi caktimin e Ndihmës Menaxherit në Projekt" ndërsa në një vend tjetër të po këtij vendimi shënon: "Menaxher të Projektit, cakton z. Fatmir Nika - Kuzhinjer".(Dëshmia 12 Vendimi Mbi caktimin e Ndihmës Menaxherit në Projekt i datës 14.07.2023). Nga të dhënat e shënuara shihet së Oferta e Grupit të OE: NNH" Verona; N.T.P Hajdini Comerc; Bylmeti- KS", as për së afërmi nuk i plotëson kriteret- kërkesat e AK të kërkuara në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontrate. Bazuar në nenin 56 paragrafi 1 pika 1.1 të LPP , nenin 59 paragrafi 4 të LPP, nenin 25 paragrafi 1 i Rregullores Nr. 01/2022 për Prokurim Publik dhe nenin 40 paragrafi 40.2 i Rregullores Nr. 01/2022 për Prokurim Publik, Autoriteti Kontraktues - Komisioni i Ri vlerësimi të ofertave është dashur që edhe ofertën e Grupit të OE: NNH" Verona; N.T.P Hajdini Comerc; Bylmeti- KS", automatikisht ta konsideroj si oferte të pa përgjegjshme dhe ta eliminoj nga aktiviteti i prokurimit për faktin së nuk i ka plotësuar të gjitha kriteret - kërkesat e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontrate, konkretisht kërkesën nr, 10 dhe 11

të Kapacitetit Teknik dhe Profesional dhe shkeljet substanciale që ka bere me rastin e paraqitjes së dy liderëve brenda të këtij grupi të OE.

Konstatimet e ekspertës shqyrtuese lidhur me pretendimet e OE “Beni Dona Plast” me Nr. 0008/2024

Konstatimet lidhur me pretendimet ankimore kundër GOE të rekomanduarit për LOT 1- GOE “Global Parajsa & Delfin LTD”

Konstatimi i parë (I): Ekspertja Shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, në ofertën e GOE të rekomanduar për kontratë për LOT 1, në folderin nr.9 gjenden katalogjet, të cilat kanë të përfshira fotografi të produkteve të ofruara për shërbim, disa produkte kanë të specifikuar vetëm masën/peshën, afati i skadimit etj, mirëpo AK në DT ka kërkuar që të specifikohen “përbërjen e artikullit, për artikujt qe kane përshkrim teknik”:Kërkesa 13. Operatori ekonomik duhet të ofroje dëshmi për produktet e ofruara me te cilat oferton e qe do te jene pjese e përgatitjeve te ushqimit , (sipas menyve te paraqitura ne DT aneksin 1 specifikimet teknike te detyrueshme): Evidenca 13.Lista e artikujve duke përfshi katalogun ose fotografitë për produktet e ofruara me përshkrim emrin e prodhuesit vendin e origjinës si dhe përmbajtjen mbi përbërjen e artikulli, për artikujt qe kane përshkrim teknik, pemët dhe perimet nuk ka nevojë përshkrimi teknik - i vulosur dhe nënshkruar nga OE ne origjinal.Andaj si e tillë, pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.

Konstatimi i dytë (II): Ekspertja Shqyrtuese lidhur me - Aneksin nr. 1- Specifikat Teknike të Detyrueshme. (Dëshmi 4- Faqja 45 e Dosjes së Tenderit) sqaron se, në ofertën e GOE rekomanduarit për LOT 1 përkatësisht në folderin nr.12 nuk e posedon aneksin komplet të skenuar, pra faqja e fundit mungon, e cila ka qenë e nevojshme të nënshkruhet dhe vuloset nga OE në fjalë, dhe si e tillë pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.

Konstatimi i tretë (III): Ekspertja Shqyrtuese lidhur me dosjen e tenderit për aktivitetin e prokurimit në fjalë sqaron se, AK në DT tek seksioni II. Fleta e të dhënave të Tenderit (FDT) sipas pikës numër 2.5 Ndarja në Lote, ka specifikuar dhe njoftuar se:Sipas nenit 18.8 të rregullores 001/2022 për Prokurim Publik. AK- ruan të drejtën se ne rast se nuk pranon oferta te përgjegjshme për ndonjë LOT atëherë do te shpërblehet me shumë LOT-e se një pjese: Shembull:Ne rast se kemi shpërblye një OE me një pjese, mirëpo për lotët tjera nuk kemi as një ofertë te përgjegjshëm AK – do te vazhdoj me shpërblim te OE te njëjte edhe ne LOT-et tjera ne rast se është i përgjegjshëm. Ndërsa sa i përket ofertës së OE të rekomanduarit për LOT 1, pas analizimit të listës sqarojmë se, OE ankuesi është më i lirë se sa GOE i rekomanduar, andaj pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.

Konstatimet lidhur me pretendimet ankimore kundër GOE të rekomanduarit për LOT 2- NNH” Verona; N.T.P HAJDINI COMERC; Bylmeti- KS”

Konstatimi i parë (I): Ekspertja shqyrtuese sqaron se, në ofertën e GOE të rekomanduarit për LOT 2, gjenden listat e projekteve, të cilat sipas titullit dhe numrit të prokurimit janë furnizim, gjersa AK ka kërkuar që 50 % të projekteve nga Lideri të ofrohen shërbim i natyrës së ngjashme të aktiviteteve të prokurimit , andaj si e tillë pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.

Konstatimi i dytë (II): Ekspertja Shqyrtuese lidhur me deklaratën e konzorciumit, e cila është e përmbledhur me një marrëveshje për tri pikat a, b, c sipas rregullores, mirëpo sa i përket liderit, pretendimi gjendet i bazuar, për faktin se, sipas deklaratave në marrëveshje, rezulton që të jenë

dy lider të grupit, me përgjegjësi të ndara, të cilët do të veprojnë në këtë aktivitet të prokurimit.

Konstatimi i tretë (III): Ekspertja Shqyrtuese lidhur me pretendimin e tretë sqaron se, OE i rekomanduar për LOT 2, ka të bashkangjitur listën e stafit, ku në dëshmitë e tyre, për personat e pretenduar nga OE ankues, konsideroj se pretendimi gjendet pjesërisht i bazuar, për faktin se, në këto dokumente nuk shihen vula, nënshkrimi etj, të cilat AK ka qenë i detyruar ti sqaroj.

Konstatimi i katërt (IV): Ekspertja Shqyrtuese lidhur me pretendimin e katërt, konsideron se AK posedon diskrecionin që ti konfirmoj të njëjtat, si e tillë pretendimi gjendet pjesërisht i bazuar.

Konstatimi i pestë (V): Ekspertja Shqyrtuese lidhur me pretendimin e pestë sqaron se, sa i përket vendimit për caktimin e menaxherit, pretendimi gjendet i bazuar, për faktin se në vendim, në fillim ceket që caktohet ndihmës menaxher i projektit, ndërsa në fund ceket si menaxher i projektit.

Si përfundim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) në kazernat Prishtinë, Gjilan, Mitrovicë, Istog, Ferizaj, Pomozotin, Gjakovë, Prizren" për nevoja të FSK-së, ndarë në 3 LOT-e. LOT 1. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) kazerna në Prishtinë. LOT 2. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) në kazernat Istog Gjakovë, Mitrovicë dhe Gjilan. LOT 3. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) kazerna në Ferizaj, Pomozotin dhe Prizren me nr. të prokurimit: "217-23-5070-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Mbrojtjes, fillimisht vlen të theksohet se AK në vlerësimin e parë ka publikuar vendimin B58 Njoftim mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit kundër dispozitave ligjore të LPP-së, mirëpo me vendimin e panelit shqyrtues me nr.2023/0768 të datës 22.11.2023, AK është detyruar që të kthej lëndën në rivlerësim, ku pastaj në proces të rivlerësimit janë rekomanduar për kontratë në tri lote, tre operator ekonomik: LOT 1: NTP "Global Parajsa & Delfin SHPK; LOT 2: NNH "Verona & NTP Hajdini Commerce & Bylmeti SHPK; LOT 3: "Beni Dona Plast" SHPK.

Tutje, në vendimin e publikuar B58-Rivlerësim, të lartpërmendurit pas refuzimit të kërkesave për rishqyrtim nga AK, janë ankuar në OSHP me numrat e lëndëve 2024/008, 2024/018, 2024/026, të cilët kanë parashtruar pretendime ankimore kundër njëri tjetrit. Gjersa, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizimit të ofertave me kërkesat e AK-së, si rrjedhojë sipas sqarimeve në shqyrtimin e pretendimeve ankimore në lëndët me raporte 8/24 18/24 dhe 26/24, rezultojnë se, tre GOE të rekomanduarit për tri lote janë të pa përgjegjshëm dhe nuk i plotësojnë kërkesat e dosjes së tenderit të përcaktuara nga AK- Ministria e Mbrojtjes.

Andaj, konsideroj se ky aktivitet i prokurimit duhet të anulohet konform Rregullores për Prokurim Publik nr. 001/2022 neni 43.5 pika b. 43.5 Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsytet e mëposhtme: b. asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm;

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se nuk pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertizës, ndërsa OE ka deklaruar se pajtohet pjesërisht.

Pretendimet ankimore të operatorit ekonomik "Global Parajsa" sipas ankesës Nr. 0018/2024

Pretendimi parë (I): Aktiviteti i prokurimit me titull: OE ankues është i rekomanduar për kontratë për LOT 1, kurse i pa kënaqur me njoftimin për rekomandim B58 -LOT 2– GOE NNH Verona &

NTP Hajdini Commerce & Bylmeti-KS”, dhe LOT 3 – GOE “Beni Dona Plast SHPK”, atëherë parashtron ankesë në OSHP kundër GOE të rekomanduara për LOT 2 dhe 3. Tutje, i njëjti në ankesë pretendon se AK nuk ka vlerësuar ofertat konform LPP-së gjegjësisht ka shkelë nenet 1, 7, 52, 59 60, 69, 72.

Pretendimet ankimore kundër GOE të rekomanduara për LOT 2- GOE NNH Verona & NTP Hajdini Commerce & Bylmeti-KS”:

OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson Kërkesën në lidhje me kapacitetin teknik dhe/ose profesional të përcaktuar në nenin 9.1 & 9.2 të FD-së ku është kërkuar: Kërkesa 10. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së njëjte apo të ngjashme në fushën e gastronomisë (përgatitje dhe servime të ushqimit gjate 3 (tri) vitet e fundit (nga data e publikimit të njoftimit për kontratë), me institucion publike dhe private, jo me pak se : 2,000,000.00 €; minimumi i kësaj vlerë të kërkuar duhet të jetë për shërbime 50% (1,000,000.00 €), dhe pjesa tjetër mund të jetë për furnizime; ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: Listën e kontratave - projekteve të realizuar përfunduar gjate tri viteve të fundit, në origjinal, të nënshkruar dhe vulosur nga Operatori Ekonomik, të dëshmuara me referenca në kopje të nënshkruar dhe vulosur nga Autoritet përkatëse , për shërbimet furnizimet e realizuara dhe pranuar , të cilat duhet të tregojnë, numrin e prokurimit ose kontratës, vlerën e kontratës , datën e nënshkrimit të kontratës , natyrën e shërbimeve dhe vendin e realizimit të shërbimeve .

a. Kur shërbimet furnizimet është bërë për një autoritet publik në Kosovës ose në një vend tjetër, për dëshmi duhet të dorëzohen certifikata e pranimit ose referenca (në referenca të jete e cekur vlera e shërbimeve) të lëshuara nga autoriteti i tillë.

b. Kur shërbimet furnizimet është bërë për një blerës privat, duhet të dorëzohet certifikata e pranimit ose referenca (në referenca të jete e cekur vlera e shërbimeve furnizimeve) të lëshuara nga blerësi i tillë. Për referenca nga institucionet private duhet të dëshmohet me qarkullim bankar nga ndonjë banke e licencuar për vlerën referencës së prezantuar.

OE i rekomanduar për kontratë në listën e referencave të ofruara si dëshmi për ta plotësuar kërkesën 9.1 dhe 9.2, ka ofruar disa kontrata dhe referenca të cilat nuk e arrijnë shumën e kërkuar prej minimum 1,000,000.00 eurove në lëminë e përgatitjes dhe servimeve të ushqimit.

Konkretisht nuk ka ofruar dëshmi për përvojë në shërbime të gastronomisë por i njëjti ka ofruar dëshmi për kontrata të furnizimeve për ushqim. Madje të gjitha këto kontrata dhe referencat që janë ofruar si dëshmi janë kontrata të realizuara për furnizime. Nisur nga ky fakt ju sqarojmë se OE i rekomanduar për kontratë është OE i pa përgjegjshëm sepse nuk e plotëson kërkesën e lartcekur dhe si i tillë do të duhet të eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit.

Lista e kontratave me furnizime nuk duhet të merret parasysh sepse është në kundërshtim me kërkesën e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë. Pra OE i rekomanduar për kontratë nuk ka arrit të dëshmojë se ka kryer shërbime në vlerë minimumi 50% (1,000,000.00 €) prej vlerës 2,000,000.00 €. Në lidhje me kërkesën e dosjes së tenderit, ju sqarojmë se ekziston një vendim i OSHP-së me Nr. 2023/0503 i dt.11.10.2023 ku nuk janë marr për bazë kontratat e furnizimeve, pasi që aty është kërkuar kontrata për shërbime të natyrës së njëjtë, prandaj edhe në këtë rast po kërkohet që kontratat të jenë për shërbime konkretisht përgatitje dhe servim të ushqimit.

LOT 3: OE Beni Dona SHPK, është i papërgjegjshëm për faktet si në vijim: Pasi që kemi qasje në dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë e kemi vërejtur se të njëjtit OE i janë kërkuar

sqarime shtesë nga ana e AK-së, në lidhje me ISO certifikatat ISO 9001/2015 dhe ISO 22000/2018, për shkak se të njëjtave ju ka skaduar validiteti pas ofertimit. ISO 9001/2015 ka skaduar 25.11.2023, kurse ISO 22000/2018 ka skaduar me dt.24.11.2023.

Pra kur analizohen ISO certifikatat e prezantuara nga OE i rekomanduar për kontratë me sqarime shihet qartë se në këtë rast kemi të bëjmë me ndryshime materiale, pasi që janë prezantuar ISO certifikata krejtësisht tjera, nga ato të cilave ju ka skaduar validiteti dhe për të cilat AK-ja ka kërkuar sqarime shtesë. Madje në këtë rast është vënë në lajthitje vetë autoriteti kontraktues, faktikisht janë mashtruar nga OE i rekomanduar për kontratë. Po ashtu dyshojmë në vërtetësinë e këtyre dokumenteve dhe kërkojmë që të vërtetohet origjinaliteti i tyre konform nenit 52.7 të LPP-së. Për tu konsideruar në rregull këto Iso Certifikata është dashur të ofrohen dëshmitë për vazhdimin e tyre e jo të ofrohen krejt dokumente të tjera, e të cilat nuk kanë të bëjnë me dëshmitë që janë prezantuar me dosje të tenderit.

Duhet cekur fakti se ky operator ekonomik edhe në tenderin paraprak të Ministrisë së Mbrojtjes, kishte prezantuar dokumente të falsifikuara, e edhe tani në këtë aktivitet të prokurimit po mundohet të manipuloj me dokumente dhe dëshmi të rrejshme. Dihet që kjo kompani është në procedurë të diskualifikimit nga pjesëmarrja në prokurim publik me kërkesën e AK-së të dt.01.02.2023. Përderisa është duke vazhduar procedura për diskualifikim dhe nuk është nxjerr një vendim final atëherë edhe referenca me Nr.3/2/2008 e dt.11.07.2023 dhe referenca Nr.3/2/002 e dt.12.01.2023 lëshuar nga Ministria e Mbrojtjes për kontratat paraprake nuk duhet të llogariten të vlefshme.

Konstatimet e ekspertës shqyrtuese lidhur me pretendimet ankimore të OE "Global Parajsa" Nr. 0018/2024

*Konstatimi i parë (I):*Ekspertja shqyrtuese sqaron se, në ofertën e GOE të rekomanduarit për LOT 2, gjenden listat e projekteve, të cilat sipas titullit dhe numrit të prokurimit janë furnizim, gjersa AK ka kërkuar që 50 % të projekteve nga Lideri të ofrohen shërbim i natyrës së ngjashme të aktiviteteve të prokurimit, andaj si e tillë pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.

*Konstatimi i dytë (II):*LOT 3: OE Beni Dona SHPK. Ekspertja Shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, në ofertën e GOE të rekomanduarit për LOT 3 gjenden ISO standardet me validitet deri me datë 24/25.11.2023, kurse në sqarim OE ka sjellë ISO me validitet deri 01.06.2025, mirëpo nga një kompani tjetër, e cila në rastin konkret paraqet ndryshim material, për faktin se, nuk janë vazhdimësi e datave në ISO standardet, të cilat janë të bashkangjitura në ofertë, andaj pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.

Tutje, në vendimin e publikuar B58-Rivlerësim, të lartpërmendurit pas refuzimit të kërkesave për rishqyrtim nga AK, janë ankuar në OSHP me numrat e lëndëve 2024/008, 2024/018, 2024/026, të cilët kanë parashtruar pretendime ankimore kundër njëri tjetrit.

Gjersa, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizimit të ofertave me kërkesat e AK-së, si rrjedhojë sipas sqarimeve në shqyrtimin e pretendimeve ankimore në lëndët me raporte 8/24 18/24 dhe 26/24, rezultojnë se, tre GOE të rekomanduarit për tri lote janë të pa përgjegjshëm dhe nuk i plotësojnë kërkesat e dosjes së tenderit të përcaktuara nga AK- Ministria e Mbrojtjes.

Andaj, konsideroj se ky aktivitet i prokurimit duhet të anulohet konform Rregullores për Prokurim Publik nr. 001/2022 neni 43.5 pika b.43.5 Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme:b. asnjëri prej tenderëve të pranuar

nuk është i përgjegjshëm;

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se nuk pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertizës, ndërsa OE "Global Parajsa" ka deklaruar se pajtohet pjesërisht.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE N.T.P "Hajdini Comerc" Nr. 0026/2024 janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I): OE ankues është i rekomanduar për kontratë për LOT 2, kurse i pa kënaqur me njoftimin për rekomandim B58 -LOT 1 – GOE Global Parajsa & Delfin LTD, atëherë parashtron ankesë në OSHP kundër GOE të rekomanduarit. Tutje, i njëjti në ankesë pretendon se AK nuk ka vlerësuar ofertat konform LPP-së gjegjësisht ka shkelë nenet 1, 4.1.26, 6 par. 1 dhe 2, 7 par.6, 27/A par.1 dhe 2, 59 par.4, 60 par. 1, 1.1, 108/A par.8, 8.4, 12; II. Dispozitat e Rregullores nr. 01/2022 të prokurimit publik (në tekstin e mëtejme do të i referohemi RRPP) dhe atë: Neni 18, Ndarja e kontratave në Lote, par 18.8; III. Mos respektim të vendimit të OSHP-se, Nr. 2023/768 i datë 22.11.2023. 1. Fillimisht, OE ankues pretendon se GOE i rekomanduar është palë pa interes në këtë aktivitet të prokurimit, sepse pas vlerësimit të parë nuk ka parashtruar kërkesë në AK/Ankesë në OSHP.

Pretendimi i dytë (II): OE ankues pretendon se AK ka rekomanduar një OE i cili tejkalon buxhetin mbi 20 % të vlerës së parashkuar.

Pretendimi i tretë (III): OE ankues pretendon se AK ka rekomanduar një GOE i cili është më i shtrenjtë se oferta jonë, mbi 43%.

Konstatimet e ekspertës shqyrtuese lidhur me pretendimet ankimore sipas ankesës 0026/2024 të OE "Hajdini Comerc"

Konstatimi i parë (I): Ekspertja Shqyrtuese lidhur me pretendimin sqaron se, AK pas pranimit të vendimit 768/23 të datës 22.11.2023 ka vazhduar me rivlerësim të të gjitha ofertave, pra ka kthyer aktivitetin e prokurimit në pikën zero.

Konstatimi i dytë (II): Ekspertja Shqyrtuese lidhur me pretendimin sqaron se, AK në këtë aktivitet të prokurimit ka iniciuar kontratë publike kornizë për 36 M, e cila konform nenit 38 të LPP-së, AK mund të aplikoj +/- 30 % nëse ka mospërputhje, andaj pretendimi i OE ankues nuk gjendet i bazuar.

Konstatimi i tretë (III): Ekspertja Shqyrtuese lidhur me pretendimin sqaron se, pas analizimit të listës sqarojmë se, OE ankuesi është më i lirë se sa GOE i rekomanduar, andaj pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.

Tutje, në vendimin e publikuar B58-Rivlerësim, të lartpërmendurit pas refuzimit të kërkesave për rishqyrtim nga AK, janë ankuar në OSHP me numrat e lëndëve 2024/008, 2024/018, 2024/026, të cilët kanë parashtruar pretendime ankimore kundër njëri tjetrit. Gjersa, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizimit të ofertave me kërkesat e AK-së, si rrjedhojë sipas sqarimeve në shqyrtimin e pretendimeve ankimore në lëndët me raporte 8/24 18/24 dhe 26/24, rezultojnë se, tre GOE të rekomanduarit për tri lote janë të pa përgjegjshëm dhe nuk i plotësojnë kërkesat e dosjes së tenderit të përcaktuara nga AK- Ministria e Mbrojtjes. Andaj, konsideroj se ky aktivitet i prokurimit duhet të anulohet konform Rregullores për Prokurim Publik nr. 001/2022 neni 43.5

pika b. 43.5 Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme: b. asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm;

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale me c'rast të dyja palët nuk janë pajtuar me mendimin dhe konstatimet e ekspertes shqyrtuese.

Paneli shqyrtues në këtë rast ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Nga sqarimet e dhëna më sipër, konkludohet se ekspertja i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatoreve ekonomik ankues. Argumentimi në raportet e ekspertizave janë mjaft të detajuar, të kuptueshëm dhe bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet e dhëna mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit dhe dokumentet e tjera, andaj pa nevojë për deklarime shtesë paneli i mbështet konstatimet e ekspertes shqyrtuese që ankesat e operatorëve ekonomik ankues të aprovohen si të bazuara ndërkaq aktiviteti i prokurimit i cituar si në dispozitiv të këtij vendimi të anulohet në tërësi.

Paneli shqyrtues me tej konstaton se i mbështet qëndrimet e dhëna në raportin e ekspertizës që ky aktivitet i prokurimit nuk është zhvilluar konform dispozitave bazë të LPP-së më saktësisht gjatë rivlerësimit nuk është bërë ekzaminimi, krahasimi dhe vlerësimi i ofertave konform nenit 59 të LPP-së.

Gjersa, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizimit të ofertave me kërkesat e AK-së, si rrjedhojë sipas sqarimeve në shqyrtimin e pretendimeve ankimore në lëndët sipas ankesave me numër protokollit 8/24, 18/24 dhe 26/24, rezulton se, tre GOE të rekomanduara për tri lote janë të pa përgjegjshëm dhe nuk i plotësojnë kërkesat e dosjes së tenderit të përcaktuara nga AK-Ministria e Mbrojtjes.

Andaj, duke pasur për bazë se të tre Ankuesit (me të dhëna të cituara si më lartë) të cilët janë ankues ndaj njëri tjetrit në procedurën e prokurimit të ndarë në lote, nuk janë të përgjegjshëm dhe nuk kanë ofertuar konform Rregullores për Prokurim Publik nr. 001/2022 neni 43.5 pika b., ku thuhet se Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet nëse asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm, paneli shqyrtues vendos që ky aktivitet i prokurimit të anulohet dhe nëse AK ka edhe me tej interes të njëjtin ta ritenderojë.

-Përfundim-

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTERIA E MBROJTJES, MINISTERIA E MBROJTJES, MINISTERIA E MBROJTJES**
- **OE - Beni Dona Plast SH.P.K., N.T.P "HAJDINI COMERC ", ISUF MUSLIU B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: